



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës
Nr. 02/ 518
Datë: 28.05.2019

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 40, nenit 82 paragrafi 1,2 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 10 dhe 19 të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871, datë:12.11.2008, kërkesës nr.020-146/3 datë:06.03.2019 të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal (MAPL), Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -V- (pestë) të mbajtur me datë: 22.05.2019 merr këtë:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS NR.02/88 DATË:07.02.2019

1. Kuvendi i Komunës së Malishevës shfuqizon vendimin nr.02/88 datë:07.02.2019 i miratuar në mbledhjen e mbajtur me datë:01.02.2019, për ndarjen e zyreve për ushtrimin e punëve dhe aktiviteteve për Shoqatën e Kryqit të Kuq të Kosovës-Dega në Malishevë dhe Shoqatën e Arsimitarëve Pensionist në Komunën e Malishevës.
2. Vendimi nr.02/88 datë:07.02.2019 për ndarjen e zyreve, për ushtrimin e punëve dhe aktiviteteve për Shoqatën e Kryqit të Kuq të Kosovës-Dega në Malishevë dhe Shoqatën e Arsimitarëve Pensionist shfuqizohet konform kërkesës nr.020-146/3 datë:06.03.2019 të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kuvendi i Komunës së Malishevës.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet
MAPL-së
Drejtoria të KK-së
Arkivit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Rrahim Morina





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Ragip Begaj , Kryetar i Komunës së Malishevës Rrahim Morina , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës
Kopje	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Ivan Todosijević , Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj , Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së
Nga:	Venera Çerkini , U.d Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Malishevës
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

Datë: 12/02/2019
Nr. 020-146

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 02-88 në parim për ndarjen e zyrave për ushtrimin e aktiviteteve për Shoqatën e Kryqit të Kuq të Kosovës- Dega Malishevë dhe Shoqatën e Pensionistëve në Komunën e Malishevës
I miratuar më datë më datë: 01.02.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 11.02.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendim Nr. 02-88 në parim për ndarjen e zyrave për ushtrimin e aktiviteteve për Shoqatën e Kryqit të Kuq të Kosovës- Dega Malishevë dhe Shoqatën e Pensionistëve në Komunën e Malishevës.	Vendim Nr. 02-88 i miratuar nga kuvendi i komunës së Malishevës, nuk është në kompetencë të kuvendit të komunës së Malishevës dhe si i tillë nuk prodhon efekt juridik. Organi ekzekutiv brenda komunës është kompetent për sistemimin e zyrave brenda komunës.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/88

Datë: 07.02.2019

Në bazë të nenit 11, nenin 12 paragrafi 2 pika d, nenin 14 paragrafi 1, nenin 17, nenit 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 10 paragrafi 1 pika h, nenit 19, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës:12.11.2008, kërkesën nr.02/492 datë:26.11.2018 parashtruar nga Kryqi i Kuq-Dega në Malishevë, kërkesën nr.02/09 datë:08.01.2019 të parashtruar nga Shoqata e Arsimitarëve Pensionist, Kuvendi i Komunës së Malishevës në vazhdimin e mbledhjes së I (parë) të vitit 2019 të mbajtur me datë:01.02.2019 merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim vendimi për ndarjen e zyreve për ushtrimin e punëve dhe aktiviteteve për Shoqatën e Kryqit të Kuq të Kosovës-Dega në Malishevë dhe Shoqatën e Arsimitarëve Pensionist në Komunën e Malishevës.
2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi autorizohet nënkryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Administratë të përgjithshme që deri në mbledhjen e ardhshme të sjellin specifikacion për të gjitha zyret dhe hapësirat e tyre që janë të lira, që janë në pronën publike të Komunës së Malishevës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:

MAPL-së

Drejtorive të KK-së

Arkivit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Rajmon Merina

